



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura e VI

Sesioni pranveror

Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini, Sport, Inovacion dhe Ndërmarrësi

Mbledhja nr. 32

Prishtinë, më 18.7.2018, në orën 10:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-204

PROCESVERBAL

Morën pjesë: Ismajl Kurteshi, kryetar, Nezir Çoçaj, Driton Çausi, Arbërie Nagavci dhe Albulena Balaj – Halimaj.

Munguan: Fidan Rekalju, Valentina Bunjaku – Rexhepi, Verica Çeraniq, Abdyl Salihu, Teuta Haxhiu dhe Mufera Shinik.

Përfaqësues të tjerë: Ramë Vataj, rektor i Universitetit të Prizrenit, Marjan Dema, Rektor i Universitetit të Prishtinës, Bajram Kosumi, rektor i Universitetit të Gjilanit, Fadil Millaku, rektor i Universitetit të Pejës si dhe përfaqësues të mediave.

Stafi mbështetës i Komisionit: Lule Ymeri dhe Shaip Goxhuli.

Mbledhjen e kryesoi, Ismajl Kurteshi, kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rendi i ditës:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Takim i Komisionit me rektorët e universiteteve publike;**
- 3. Të ndryshme.**

1. Miratimi i rendit të ditës;

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

2. Takim i Komisionit me rektorët e universiteteve publike

Ismajl Kurteshi, i falënderoi rektorët për përgjigjen e tyre në ftesën e Komisionit dhe i ftoi atë që të shpalosin planet e tyre si dhe sfidat me të cilat përballen.

Ramë Vataj, rektor i Universitetit të Prizrenit “Ukshin Hoti”, tha se më 5 korrik 2018, rektorët kanë mbajtur Konferencën e Rektorëve, me ç’rast kanë shpalosur shqetësimet e tyre dhe nevojën për ndihmën e institucioneve qeveritare për t’i tejkaluar këto sfida. Si rezultat i kësaj Konference, dolën disa pika që u cilësuan si më kyçe dhe problematike për universitetet. Fillimisht, ai përmendi, mungesën e autonomisë financiare, e cila pengohet nga Ministria e Arsimit. Vataj tha se çdo gjenerim i të hyrave nga universitetet, derdhet në buxhetin e Kosovës, gjë që ndikon në demotivimin e profesorëve për të punuar dhe aplikuar në ndonjë projekt. Mungesa e autonomisë financiare ndikon edhe në reduktimin e bursave dhe në mungesën e linjës së veçantë për hulumtime shkencore. Edhe pse ka pasur rritje të numrit të stafit dhe studentëve, buxheti është zvogëluar edhe më shumë. Vataj tha se që nga momenti kur e ka fituar pozitën e rektorit, Ministrisë së Arsimit i janë dërguar kërkesa për planifikim buxhetor dhe nevojë të stafit, por që nuk janë përfillur asnjëherë nga kjo e fundit.

Çështje tjera që u cilësuan si probleme, të dala nga Konferenca e Rektorëve, ishin edhe statutet e përkohshme të universiteteve, pagat e ulëta të profesorëve universitarë si dhe pengesat nga institucionet tjera jokompetente për vlerësimin e cilësisë, duke përmendur këtu Inspektoratin e Arsimit.

Marjan Dema, Rektor i Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina”, tha se kanë trashëguar një vëllim të madh të punës, mirëpo, që synimi është që Universiteti i Prishtinës të jetë një universitet prestigjioz duke u mbështetur në mësimdhënien cilësore, hulumtimet shkencore dhe punën praktike e vullnetare. Universiteti i Prishtinës, tha Dema, ka treguar përparim sa i përket cilësisë dhe fushave tjera në të cilat vërehet dukshëm suksesi.

Ai tha se janë ndarë 8 fusha strategjike, ku janë të paraparë faktorët, kostot dhe pritjet, në mënyrë që të realizohet vizioni dhe përparimi. Gjithashtu, rektori Dema theksoi se synimi i Universitetit të Prishtinës, është thithja e fondeve evropiane dhe ndërkombëtare dhe ndërkombëtarizimi i universitetit, ndërsa sa i përket cilësisë, ai tha se mbi 60% të komisioneve i takojnë fushës së cilësisë së brendshme.

Dema përmendi edhe mungesën e stafit akademik dhe administrativ si dhe hapësirën shumë të kufizuar për studentë.

Bajram Kosumi, rektor i Universitetit të Gjilanit “Kadri Zeka”, tha se pikat e parashtruara nga kryesuesi i Konferencës së Rektoreve, qëndrojnë dhe që kanë mbështetjen e plotë të të gjithë rektorëve. Ai përmendi zhvillimet pozitive në dy vitet e fundit në Universitetin e Gjilanit, duke thënë se numri i studentëve është rritur deri në 8000 studentë, që është një numër shumë i madh në krahasim me kapacitetet që ka ky Universitet. Kosumi theksoi se në disa programe studimore si ekonomik dhe juridik, është reduktuar numri i studentëve të pranuar, kurse ky numër është rritur në programet e tilla, si shkencat kompjuterike dhe shkencat e profilizuara të nivelit Master. Gjithashtu, ai tha se edhe stafi akademik ka pasur një zhvillim të madh, duke marrë parasysh faktin që universiteti i Gjilanit ka pasur vetëm katër profesorë të rregullt kurse tash i ka 30 profesorë me orar të plotë dhe rreth 80 profesorë të angazhuar, ndërsa sa i përket administratës, Kosumi tha se edhe aty është shënuar sukses dhe pritet që ajo të bëhet autonome nga të gjitha institucionet e tjera.

Ai tha se edhe programet studimore nga 4 që kanë qenë, janë rritur në 9 programe studimore, të gjitha të akredituara deri në vitin 2021. Sa i përket, nivelit të doktoratës, rektori tha se agjencia e akreditimit ka pezulluar proceset për një vit. Është hartuar një plan strategjik për ngritjen e cilësisë në Universitet, mirëpo, kjo po zbatohet me vështirësi.

Në anën tjetër, rektori Kosumi theksoi se nga 2 projekte që ka pasur Universiteti i Gjilanit me Komisionin Evropian, ka kaluar në 16 projekte, ku në njërin prej tyre janë edhe koordinator. Gjithashtu, ai tha, se avancime janë bërë edhe në mësimin digjital, ku përmes SEMS-it, në Universitet është instaluar MOODLE, e që synohet edhe sistemi e-learning.

Kosumi përmendi edhe sfidat me të cilat përballlet Universiteti i Gjilanit, e njëra nga sfidat më të mëdha është statuti i përkohshëm i cili është shumë i kufizuar, duke nënkuptuar që MASHT-i ka dështuar që 3 vite të sjellë në Kuvend statutet e përkohshme.

Çështje tjetër, që rektori e veçoi si problematike, ishte edhe çështja e kampusit universitar që sipas tij nuk i plotëson as 20% nevojat e një kampusi universitar. Kurse sa i përket cilësisë, ai tha se, nuk mund të flitet për cilësi kur një profesor mëson rreth 200 studentë, mesatare dhjetë herë më e madhe krahasuar me standardet evropiane. Në anën tjetër, Kosumi theksoi që politizimi po dëmton shumë universitetet publike, duke përmendur rastin e proklamimit të mbylljes së universiteteve me ç’rast shumë profesionistë kanë hezitur të aplikojnë për pozita përkatëse për shkak të pasigurisë që ata kanë hasur.

Kosumi bëri thirrje që të sigurohet autonomia financiare, administrative dhe ajo politike, në mënyrë që të ketë përmirësime në gjendjen aktuale.

Ramë Vataj, rektor i Universitetit të Prizrenit “Ukshin Hoti”, tha se ndërhyrjet nga jashtë po pengojnë jashtëzakonisht punën e universiteteve. Ai theksoi si problem kyç buxhetin, i cili pengon funksionimin e universitetit, e që pengohet nga MASHT-i. Gjithashtu përpos ndërhyrjeve buxhetore, rektori tha që MASHT-i ka shkelur edhe autonominë akademike të

Universitetit të Prizrenit dhe bëri thirrje që të anulohen konkurset për staf akademikë dhe vendimet e senatit për zgjedhjen e stafit.

Vataj njoftoi se e ka përgatitur raportin i cili është përmbledhje e punës dhe sfidave të universitetit dhe gjithashtu i bëri thirrje Komisionit ti ndihmojë universiteteve në këtë drejtim.

Fadil Millaku, rektor i Universitetit të Pejës “Haxhi Zeka”, tha se problemet e universiteteve janë pothuajse të përbashkëta. Numri i stafit akademik është 75 kurse administrata është e kompletuar, ku funksionale janë të gjitha zyrat. Ai shtoi që për shkak të mosfunksionimit të Agjencisë së Akreditimit, disa programe nuk janë akredituar, gjë që ka dëmtuar Universitetin e Pejës. Instalimi i pajisjeve elektronike që regjistron mbarëvajtjen e ligjëratave ka ndikuar pozitivisht në funksionimin e mësimit dhe në ngritjen e cilësisë. Sa i përket problemeve, ai theksoi buxhetin e limituar që ndikon në mosndarjen e bursave për studentët, ndërhyrjen e MASHT-it dhe të Inspektoratit të Arsimit në përzgjedhjen e stafit akademik si dhe cilësinë e dobët që vjen si pasojë e testit kombëtar dhe parregullsive që ndodhin gjatë këtij procesi.

Ismajl Kurteshi, tha se Ligji për Inspektorë të Arsimit është në prag të aprovimit dhe se me anë të këtij ligji, inspektorët do të ndahen në tri kategori: inspektorë administrativë – të vetmit të cilët kanë të drejtë të mbikëqyrin vetëm respektimin e procedurave administrative dhe assesi të bëjnë vlerësimin e cilësisë. Ai gjithashtu tha se Komisioni do të shqyrtojë raportin e përmendur nga zotëri Vataj si dhe të gjitha ankesat dhe shqetësimet e rektorëve dhe se Komisioni do ti paraqes para Ministrit të Arsimit.

Arbërie Nagavci, tha sa nga ky raportim, shqetësimi i saj për arsimin e lartë është rritur edhe më shumë. Përkundër faktit që një barrë të madhe të përgjegjësisë mbi cilësinë e arsimit e kanë edhe mësimdhënësit e shkollave fillore dhe të mesme, janë mësuesit që dalin nga universitetet për t'i mësuar fëmijët. Ajo tha se pajtohet me qëndrimin e rektorëve që autonomia financiare është një ndër sfidat më të mëdha me të cilën përballen universitetet, sfida e cila duhet të tejkalohet, në mënyrë që të sigurohet edhe cilësia në arsim.

Nagavci kërkoi nga rektorët të ofrojnë informata për numrin e profesorëve doktorë me orar të plotë në secilin prej departamenteve të tyre, për proporcionin profesorë –studentë dhe se a kanë ndonjë mekanizëm apo studim që mat cilësinë dhe vlefshmërinë e diplomave që marrin studentët e universiteteve. Ajo kërkoi nga rektorët, që në mënyrë specifike ti cekin problemet të cilat do t'i ballafaqojnë si pasojë e mosfunksionimit të Agjencisë së Akreditimit.

Nezir Çoçaj, falënderoi rektorët për raportimin e tyre dhe për punën e bërë, angazhimin e treguar drejt ngritjes së cilësisë. Çoçaj tha se nuk mund të presim cilësi në arsim, kur buxheti është i limituar dhe që investimi në arsim është investimi më i mirë. Ai kërkoi nga rektorët të dijë se a ka pasur rritje të buxhetit me ardhjen e qeverisë së re në pushtet, mbi punën e rektorëve për përgatitjen e stafit si dhe a kanë ndonjë marrëveshje për shkëmbim të studentëve me universitetet evropiane dhe botërore. Gjithashtu, kërkoi informata se sa kanë qasje universitetet nëpër

bibliotekat elektronike të universiteteve, kurse e konsideroi si shqetësues faktin që në projektin e BE-së, HORIZON 2020, vetëm katër projekte kanë qenë nga Kosova.

Ai tha se BE-ja ka ndarë 36 milionë euro për Ballkanin Perëndimor dhe se kjo nënkupton edhe përgjegjësi nga ana e rektorëve dhe mekanizmave tjerë që ti shfrytëzojnë këto fonde, ashtu siç duhet.

Albulena Balaj - Halimaj, tha se Konferenca e Rektorëve e mbajtur me 5 korrik, shënon një hap të rëndësishëm drejt adresimit të duhur të çështjeve dhe problemeve me të cilat ballafaqohen universitetet. Ajo shprehu shqetësimin e saj lidhur me ofendimin e punës së inspektorëve të arsimit dhe zyrtarëve të MASHT-it, duke i cilësuar si persona të pashkollë. Ajo shtoi që nëse universitetet në fjalë nuk kanë cilësi dhe nuk zotërojnë kapacitete për të siguruar cilësinë, atëherë pse duhet të ekzistojnë. Ajo tha se është kundër qëndrimit që në Kosovë të ekzistojnë kaq shumë universitete publike dhe private.

Në anën tjetër për të shprehur pakënaqësinë e saj rreth qasjes ndaj ministrit të Arsimit, ajo tha se nëse problemi i vetëm qëndron tek ministri, atëherë ai mundet edhe të shkarkohet, mirëpo, që problemi nuk ka filluar e as nuk do të përfundojë tek ministri Bytyqi.

Duke ju drejtuar z. Vataj për autonominë politike, ajo i tha se politika më e madhe qëndron në faktin që i vet është rektor i universitetit dhe duke pasur parasysh që secili anëtarë prej Këshillit Drejtues është kërcënuar deri sa është votuar rektori.

Ajo theksoi se autonomia respektohet deri në atë masë që nuk bëhen shkeljet sepse në atë moment që bëhen shkelje, Ministria ndërhyr dhe kjo nuk mund të quhet shkelje e autonomisë. Gjithashtu ajo tha që në Universitetin e Prizrenit mund të hapen edhe shumë drejtime tjera, e që për shkak të rektorit nuk po ndodh kjo, gjë që e dëmton arsimin në Kosovë.

Ajo shfaqti shqetësimin e saj lidhur me qasjen e disa profesorëve të caktuar, lidhur me studentët dhe kërkoi nga rektorët të dijë se a janë në dijeni për këto ndodhi dhe sa a kanë marr ndonjëherë masa.

Driton Çausi, pasi falënderoi rektorët për paraqitjen e tyre, tha se shqetësuese për të, që nga ideja fillestare e hapjes së universiteteve paralele përveç universitetit të Prishtinës, është vlerësimi strategjik i kësaj ideje, pasi që këto universitete janë hap në prag të fushatave elektorale dhe që më së shumti nga kjo e ka pësuar Universiteti i Prishtinës. Ai tha, se një vend i vogël siç është Kosova, me 1.7 milion banorë, 7 universitete publike janë shumë. Në anën tjetër, tha se fakti që universitetet kanë numër të limituar të stafit akademik, nuk mund të kërkohet cilësi dhe pyeti rektorët, se në rast se do të bëhej vlerësimi i punës së këtyre universiteteve, cili do të ishte vlerësimi i tyre objektiv mbi to.

Ismajl Kurteshi, tha se sa i përket statutit të përkohshëm të universiteteve, çështje e cila është diskutuar edhe në mandatin e kaluar, Komisioni me kërkesa konkrete nga MASHT, do të arrijë

në zgjidhje konkrete për këtë problem. Ai tha se ndërhyrjet politike nuk janë të panjohura në Kosovë dhe që janë tepër të dëmshme, mirëpo, që më së lehti mund të mënjahen nga ana e rektorëve, duke mos rënë pre e këtyre ndikimeve politike. Në anën tjetër ai tha se secili nga rektorët përmendi sfida të mëdha me të cilat ballafaqohen universitetet e që nuk do të duhej që për synim të kishin rritjen e numrit të studentëve.

Për fund kërkoi nga rektori Demaj, të dijë se si e kanë bërë matjen e rritjes së cilësisë, kurse nga të gjithë kërkoi të dijë se në momentin që hapen drejtime të caktuara, a merret parasysh tregu i punës apo është proces që është shndërruar në rutinë.

Marian Demaj, rektor i Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina”, tha se për çdo sukses që është arritur, është e evidentuar në Raportin e Progresit dhe që janë të prekshme. Sa i përket doktorëve të shkencës, ai tha se janë 514 doktorë shkence në proces mësimor dhe që përmes punës horizontale që është bërë është ngritur cilësia. Kurse, për cilësinë e të diplomuarve, ai tha se është duke u realizuar një softuer elektronik për matjen e cilësisë, mirëpo që kjo merr kohë më të gjatë. Mosfunksionimi i Agjencisë së Akreditimit ka krijuar një ndjenjë hezitimi të studentëve dhe partnerëve, tha rektori Demaj. Ndërsa, sa i përket rritjes së buxhetit, ai tha që buxheti i Universitetit të Prishtinës është i njëjti tash 3-4 vite me radhë. Në anën tjetër, për përgatitjen e stafit, ai tha se janë themeluar shumë zyra, ku njëra ndër to është edhe Zyra për Përsosmëri në Mësimdhënie, ku si kriter është futur edhe certifikimi i mësimdhënësve.

Demaj tha sa Universiteti i Prishtinës ka më shumë se 300 marrëveshje ndërkombëtare, mirëpo, kërkohet më shumë angazhim. Sa i përket librarisë elektronike, ai tha se nuk është bërë shumë në këtë aspekt, mirëpo, që tërë puna që po realizohet, po bëhet në përputhje me kriteret evropiane. Demaj tha se ndërhyrja politike është trashëguar, mirëpo që ai është i lirë nga të gjitha gjykimet.

Ramë Vataj, rektor i Universitetit të Prizrenit “Ukshin Hoti”, tha se Universiteti i Prizrenit ka gjithsej 63 doktorë shkence, kurse sa i përket proporcionit studentë – profesorë, janë diku rreth 50 studentë për 1 profesorë, duke llogaritur vetëm studentët aktivë. Ai tha se cilësia matet në mënyrë të brendshme me anë të zyrtarëve të Zyrës për Cilësi, të cilët çdo 2 – 3 vjet hartojnë një raport të vetëvlerësimit mbi cilësinë e programeve.

Vataj theksoi se ka shumë studentë të cilët vazhdojnë studimet e tyre jashtë vendit si dhe ka asistentë, profesorë të cilët kanë fituar bursat për të avancuar studimin e tyre. Nga ana tjetër, ai tha se buxheti nuk ka pësuar rritje, por përkundrazi ka pësuar rënie edhe pse është shtuar numri i studentëve. Ai tha se përveç projekteve me ERASMUS, universiteti nuk ka aplikuar në projekte ndërkombëtare për shkak të mungesës së kapaciteteve.

Sa i përket ndërhyrjeve politike, ai tha se kjo është vërtetuar me rastin e zgjedhjes së rektorit, ku Ministria ka urdhëruar të respektohet vendimi i Inspektoratit për anulim të pozitës, në mënyrë të jashtëligjshme. Ai kërkoi falje nëse ka quajtur zyrtarët e Ministrisë dhe të Inspektoratit si të pashkollë, duke u sqaruar që praktikisht dikush që është në pozitë më të ulët se profesorët, nuk

mund të bëjë vlerësim të cilësisë. Gjithashtu, ai tha, që i ka plotësuar kushtet për pozitën e rektorit dhe që me punën e tij e ka dëshmuar veten.

Rektori Vataj, shtoi që vlerësim të publikimeve shkencore nuk ka për momentin sepse duhet të ekzistojë një sistem me anë të të cilit do të bëhej vlerësimi, mirëpo, ekziston një pyetësorë i ENCA-s, që në mënyrë anonime bën vlerësimin e punimeve shkencore.

Bajram Kosumi, rektor i Universitetit të Gjilanit “Kadri Zeka”, tha se arsyeja se pse në pah janë vënë vetëm dukuritë negative dhe problemet, është që universitetet kanë nevojë për ndihmën e Komisionit, mirëpo, që kjo krijoi bindjen e gabuar për mosfunksionimin dhe mos cilësinë e universiteteve. Ai tha se ka shumë studentë të shkëlqyer që vijojnë studimet edhe jashtë vendit dhe që jo 100% po të paktën 20% të diplomave që lëshohen, janë më të mirat në Evropë.

Ai shtoi se cilësia në universitete nuk është ajo që do të dëshironin, mirëpo, që brenda kapaciteteve punohet maksimalisht. Gjithashtu, ai theksoi që krahasimet nuk duhet të bëhen më Universitetin e Harvardit dhe të rangut të tillë sepse ashtu do të mbylleshin të gjitha universitetet, mirëpo, brenda mundësive që ofrohen dhe kapaciteteve që kanë, ashtu edhe do të duhej të vlerësoheshin.

Sa i përket vlerësimit të tregut para hapjes së ndonjë drejtimi, ai tha se Universiteti i Gjilanit është i obliguar që të bëjë një analizë të tregut, në mënyrë që të procedohet me hapjen e ndonjë drejtimi të ri. Ai tha se shpërndarja e universiteteve në 7 qendra, i ka dhënë mundësi Kosovës që të zhvillojë 7 qendra më të forta, për dallim prej disa shteteve tjera që kanë vetëm një qendër universitare e që pjesa tjetër mbetet shumë mbrapa me zhvillim.

Ismajl Kurteshi, falënderoi rektorët për raportimin në lidhje me punën e tyre dhe sfidat që ata përballojnë.

3. Të ndryshme.

Për këtë pikë nuk pati diskutime.

Mbledhja e Komisionit përfundoi në orën 12:30.

E përgatiti:

Stafi mbështetës i Komisionit.

Kryetari i Komisionit,

Ismajl Kurteshi